Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**08.09.2023**	**25.09.2023**	**2023/0652**
Eksperti Teknik **Kreshnik Spahiu**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **13.09.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.09.2023, OE "AXA SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0652, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "TECH VISION", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje te Teknologjise Informative" me nr. të prokurimit: "205-23-8293-5-5-8", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E INFRASTRUKTURES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë, furnizim.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues/teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Ftesa per ofertim 07.08.2023

Hapja e ofertave 16.08.2023

Njoftimi mbi vendimin e AK-së 23.08.2023

Kërkesa për Rishqyrtim 26.08.2023

Përgjigjja ndaj kërkesës për Rishqyrtim 30.08.2023

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 7 LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 38 LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 59 LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 28 LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 60 LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 69 LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 108A LPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 54 RRPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 27 RRPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 54.4, 54.7, 54.35 ,54.42 e),f) RRPP-së

Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Infrastrukturës ka shkelur nenin 10 Udhëzuesit-ë

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Pas marrjes se njoftimit për eliminim te ofertës sonë , ne aktivitetit te prokurimit nga ana e AK- MINISTRIA E INFRASTRUKTURES , ne po paraqesim kërkesën ton për rishqyrtim pasi jemi shpall te pa përgjegjshëm ne aktivitetin e prokurimit te mini tenderëve ne kundërshtim te plote me LPP, Nenin 38.

Pretendimi 1

Autoriteti Kontraktues i MINISTRIA E INFRASTRUKTURES ka bere shkelje te mëdha gjate procesit te vlerësimit te ofertave pasi jemi diskriminuar si Operator i Ekonomik pasi i kemi plotësuar kriteret administrative e dosjes se tenderit qysh ne tenderin e kontratës korniz te

shpallur nga AQP-ja.

Pra ne baze te këtyre arsyeve te dhëna ne besoj se jemi te diskriminuar nga komisioni i vlerësimit te ofertave.

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik drejt ne përputhje me specifikat e dosjes se tenderit dhe jo- diskriminoj dhe do të veprojë në mënyrë kundër ligjshëm te rekomandoj kompaninë qe nuk i plotëson kriterin e dhënies se ofertës çmimin me te ulet te tenderi deri sa ne i kemi plotësuar specifikimet teknike dhe kemi dorëzuar Deklaratën e specifikimeve teknike ne fazën e kualifikimit dhe nuk ka nevoje te dorëzohet çdo here.

Pretendimi 2

Gjate fazës se vlerësimit te ofertave komisioni i vlerësimit ka vepruar kundërligjshëm pasi ne e kemi jep deklaratën e specifikimeve teknike ne fazën kualifikues dhe ne baze te ligjit duhet te qëndrojmë deri ne përfundimin e kontratës kornizë te mini tenderëve.

AXA

company: **AXA Ltd.**
address: Str. Skender Çeku, OB C6, A, L-6, 10000 Prishtina, XK, EU
contact: +386 49 80 97 05
email: axa@axa-ks.com
koman@axa-ks.com
web: www.axa-ks.com

Deklaratë për garancion dhe përputhshmëri teknike të produkteve

utoriteti Kontraktues: **Agjencia Qendrore e Prokurimit**
Titulli: **Marrëveshje kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative**
Numri i Prokurimit: **UA/2016-19-9628-1-1-1**

ërmes kësaj shkrese deklarojmë se do t'i përmbushim plotësisht kërkesat e AK si:

- Garancioni për produktet e ofruara: 3 vite.
- Deklarojmë se specifikacionet teknike të ofruara , përputhen plotësisht më ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjës së tënderit.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	AXA SHPK
Adresa e plotë:	Rr. Skender Çeku, OB C6, A, L-6, 10000 Prishtina, XK, EU
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Koman Gashi
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	26.02.2020
Vula:	

Gjithashtu ne baze te ligjit te prokurimit dhe RRPP kërkesat administrative qe janë kërkuar ne fazën kualifikues nuk duhet te kërkohen edhe gjate fazës se mini tenderëve pasi ne jemi kualifikuar nga AQP-ja dhe i bije qe te përsëriten kriteret. Faza e mini - tenderëve ne baze te nenit 54.1 duhet te shmangen kritereve te njëjta dhe por kontrata duhet te epet sipas nenit 54.42- e) , f) kriteri për dhënie është - tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Gjithashtu ne si OE i kemi ngarkuar ne sistem deklaratën e gracionit te pajisjeve ku ceket se qëndrojmë siq kërkohet ne ftesën për ofertim : shih deklaratën

Përmes kësaj deklarata zotohemi se garancioni për te gjitha pajisjet e ofertuar është siç

kërkohet

Gjithashtu ne baze te vendimeve te OSHP-se 14/2023 , 633-635-22 deklarata e specifikimeve teknike nuk është kriter vlerësues pasi nuk është kërkuar ne mënyrë te veçante por është e formës standarde ftesës për ofertim.

Shikoni vendimin e OSHP-se 14/23 ,

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e parashtruar te OE ankues i cili pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike si qe është kërkuar ne dosjen e tenderit ne FTD pika 3.1 ., PSH konstaton se AK nuk ka specifikuar ose veçuar ndonjë deklaratë specifike apo katalog/broshurë lidhur me specifikacionet teknike te Aneksit 1 ku forme e tille është forme standarde dhe si e tille nuk është kriter vlerësues, me këtë rast PSH vlerëson se pretendimi ankimore është i pa bazuar.

vendimi 633-635-22

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është operator ekonomik i papërgjegjshëm dhe i cili nuk ka respektuar kërkesat e FDT-Seksioni II-Fleta e te dhënave te tenderit, kërkesa për Deklarate te Specifikave, paneli shqyrtues sqaron se AK ka përdorur formularin standard te miratuar nga KRPP-ja B15 Dosja e Tenderit - Furnizim - Procedura e hapur, ku ne bazë te këtij formulari tek Seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit (FTD) përkatësisht pika 3.1 thuhet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka përdorur formularin standard te miratuar nga KRPP-ja B15 Dosja e Tenderit - Furnizim - Procedura e hapur, të cekur si në pretendimin ankimor. AK nuk ka përcaktuar apo veçuar ndonjë deklarate specifike lidhur me specifikimet teknike te Aneksit 1, forma e tille është forme standarde e pamodifikuar e dosjes se tenderit pra e njëjta është shabllon. AK ka kërkuar qe "Operatori

4

Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë broshura për produkte të ofruar duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike te Detyrueshme-Anexi 1", andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të dytë të OE ankues, paneli shqyrtues sqaron se AK ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit ka prezantuar specifikimin teknik për kamionin e kërkuar, ne te cilin specifikim janë te specifikuara kërkesat qe duhet ti plotësoj automjeti i ofruar nga ana e OE ofertues. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate nga ana e KK Mitrovice ka dorëzuar specifikimin teknik për automjetin e ofruar i cili nuk i përmban disa nga kërkesat e specifikimit teknik qe janë kërkuar. Ne specifikimin teknik te operatorit ekonomik te rekomanduar për kontrate është i specifikuar tipi i automjetit por nuk është specifikuar se me çfarë modeli ka ofruar po ashtu nuk ka prezantuar te dhëna për numrin e rrotullimeve te motorit. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne specifikimin teknik te dorëzuar nuk e ka te specifikuar se automjeti i ofruar a i plotëson edhe kërkesat e specifikimit teknik qe kane te bëjnë me Pompa për zjarrfikëse.

Pretendimi 3

Autoritetet Kontraktuese do ti shpërblejnë kontratën operatorit ekonomik që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterit të dhënies të përcaktuar në ftesën për ofertim.ne këtë rast ne jemi me çmim me te lire dhe këtu është vete ne baze te thirrjeve qe behet pra ne baze te porosis FPO.

Pretendimi 4

Komisioni i Vlerësimit i AK-se dhe ZKP-ja kanë bere shkelje te nenit 59 te LPP_se pasi ka rekomanduar për kontrate kompaninë qe nuk i ka plotësuar specifikimet teknike qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit. Gjithashtu komisioni i vlerësimit pavarësisht qe e ka dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike OE i rekomanduar ne broshurat qe i ka dorëzuar për pajisje kompjuterike nuk e plotësojnë specifikat teknike qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit dhe është

dashur te eliminohet me këtë mundem me konstatuar se komisioni i vlerësimit dhe ZKP kane qene subjektiv ne vlerësim te ofertave.

Gjithashtu duke u bazuar ne nenin 10 te Udhëzuesit për Prokurim Publik te Kosovës nëse nuk është plotësuar specifikimi teknik duhet te refuzohet tenderi automatikisht shkelje e nenit 28 te LPP-se.

Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar)	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	28
Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Shikoni se qa nuk ka plotësuar:

1. Tek produkti Desktop AIO, procesori eshte kerkuar:

Intel core i7 gjenerata e parafundit (min. 10 core up to 5.0 GHz), ndersa OE e shpallur fituese ka ofertuar procesor me te ngadalshëm: Procesor speed max turbo 4.90.

2. Tek produkti Desktop AIO eshte kerkuar:

Screen Resolution: Min. FHD (1920x1080) IPS, Viewing Angle min. 85° at te pakten djathtas/majtas/lart /poshte), borderless - Multi touch(10point0, Touch Screen, ndërsa OE e shpallur fituese me produktin e ofruar nuk e përkrahë opsionin MULTI TOUCH 10 point

3. Tek produkti Desktop AIO eshte kerkuar:

Lexuesi optik: DVD RW (+/- RW)- Nuk pranohen te jashtme, OE e shpallur fituese ka ofruar produkti HP EliteOne 840 G9 AIO, ku i cili nuk ka fare Lexues Optik

4. Tek produkti Desktop AIO eshte kerkuar:

Grafika; Minimum : HDMI in, HDMI Out (2.1) ose porte te tjera me te mira(nuk pranohen Combo), ndërsa OE e shpallur fituese ka ofruar grafiken te cilën e ka nënvizuar Intel® UHD Graphics 730, e cila ka vetëm me opsionin HDMI in.

Gjithashtu kompania e rekomanduar për kontrate ka mashtruar Autoritetin Kontraktues pasi ka ndërhy ne broshurat/katalogun e prodhuesit qe i bije ka modifikuar broshurat dhe kjo duhet te ishte eliminuar ky OE pasi ka jep deklaratë te rrejshme kur ka dorëzuar deklaratën për specifikim teknik.

Tek produkti Desktop AIO eshte kerkuar:

Granancioni 3 vite, te dëshmohet nga prodhuesi, OE ka falsifikuar broshurën dhe poashtu nuk ka paraqit deklaratën nga prodhuesi per garancion 3 vjeçar. Tek broshura e paraqitur nga OE fituese pe produktin HP Desktop Eliteone 840 G9, Operatori Ekonomik ka ndërhyrë ne katalogun e prodhuesit, gjë qe paraqet vepër penale paraqitja e dokumenteve te falsifikuara. Shihet qarte edhe Editimi qe është bere tek garancioni, respektivisht Warranty: 3 year ne te dy vendet, ku prodhuesi e shenon "years", pra ketu kemi te bëjmë me garancion 1 vjeçar dhe jo 3 siç është kërkuar ne specifikacionet minimale te kërkuara.

3 year (3/3/3) limited warranty includes 3 year of parts,

720p NTSC

Shikoni Linqe për verifikim:

https://h20195.www2.hp.com/v2/GetPDF.aspx/c08128755.pdf

https://h20195.www2.hp.com/v2/GetPDF.aspx/c08128770.pdf

VENDIM

APROVOHET, si te bazuar Ankesa e GOE: AXA SHPK & TMS Mobile Shpk

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhënie te kontratës date 23.08.2023 dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM, Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me specifikat e dosjes se tenderit.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjitha

palët qe kane marr pjesë ne këtë aktivitet te prokurimit

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpërblen m
e Operatoreve Ekonomik TECH VISION SH.P.K.; Mehmet Sahitolli B.I.; Nita M
1, -10000, PRISHTINË, Kosovëpër një shumë prej 98,518.00 €

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Request for information

Marinovic, Drazen <drazen.marinovic@hp.com>

Today, 12:09

Dear Mr. Bellanica,

Brochure for HP EliteOne 840 G9 AiO PC is public document and everybody can reach it at;
https://h20195.www2.hp.com/v2/GetPDF.aspx/c08128755.pdf

From your question I can suppose that you have a concern about warranty of offered product.
I draw your attention that basic warranty for HP EliteOne 840 G9 AiO PC is 1 year but can be easily upgraded to 3 or 4 or 5 years warranty through HP care paq's.

HP do not participate in partner decision what warranty to offer and that decision is autonomous right of HP partner.

Yours sincerely,

Drazen Marinovic
CDG End User Sales Manager
+385916060214

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues kualifikohet si pale me interes sipas nenit 4 pika 1.26 i LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **AXA SH.P.K.**

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Sqarim hyrës

OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 26.08.2023. AK ka nxjerr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë 30.08.2023. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP duke diskualifikuar OE ankues lidhur me deklaratën për specifik teknike.

Rrethanat e çështjes

Ky aktivitet është zhvilluar si procedurë e mini-konkurencës, duke u bazuar në Marrëveshjen Kornizë për Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative me numër të identifikimit: UA/2016-19-9628-1-1-1/FA-153, të lidhur në mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe gjashtëmbëdhjetë (16) OE-ve, të cilët janë të parakualifikuar dhe Autoritetet Publike janë të obliguar që sa herë të paraqitet nevoja të dërgojnë Ftesë për Ofertim tek të gjithë OE-të. Sipas RrPP.

Në dosjen e tenderit të publikuar nga AQP me numër UA/2016-19-9628-1-1-1, në nenin 3.1 thuhet: OE duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ne rast te mos përfshirjes se garancit ne katalogje mjafton kjo

deklarat (per produketet ku kërkohet 1 vit ose 2 vite garancion); dhe b. Specifikat teknike në Aneksin 1 janë vetëm specifika minimale ndërsa në fazën tjetër AK mund te përpilojnë specifika teknike më të avancuara për ti përmbushur nevojat dhe kërkesat e tyre. Specifikat e hartuara ne fazën e mini-tendereve duhet te jenë në harmoni me LPP-në.

AK në Ftesën për Ofertim, të publikuar me datë 07.08.2023, tek neni IV - Kushtet e tenderimit, përkatësisht tek IV.6-Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara, ndër të tjera është paraqitur kërkesa *b. Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së.*

OE ankues në tenderin e dorëzuar nuk ka bashkangjitur një deklaratë për specifikacionet teknike sikurse në kërkesën e sipërpërmendur.

Referuar kërkesës për rishqyrtim të paraqitur pranë AK-së, me datë 26.08.2023, dhe në këtë ankesë, në pretendimin ankimor që lidhet me këtë pike OE ankues ka paraqitur arsyetimin si vijon: "[...] *deklaratën e e specifikimeve teknike e kemi dorëzuar ne fazën kualifikues dhe ne bazë te ligjit duhet te qëndrojmë deri ne përfundimin e kontratës kornizë të mini tenderëve. Gjithashtu në bazë të ligjit te prokurimit dhe RRPP kërkesat administrative qe janë kërkuar ne fazën kualifikues nuk duhet te kërkohen edhe gjatë fazës se mini tenderëve pasi ne jemi kualifikuar nga AQP-ja dhe i bije qe te përsëriten kriteret. Faza e mini - tenderëve ne baze te nenit 54.1 duhet te shmangen kritereve te njëjta dhe por kontrata duhet te epet sipas nenit 54.42- e), f) kriteri për dhënie është - tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Gjithashtu ne si OE i kemi ngarkuar ne sistem deklaratën e garancionit te pajisjeve ku ceket se qëndrojmë siç kërkohet ne ftesën për ofertim: shih deklaratën.*

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 1</u>

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se konform nenit 54.33 të RrPP, AK-AQP ka lidhur Marrëveshje kornizë ku nuk janë vendosur të gjitha termat dhe kushtet. Duke u bazuar në në dosjen e tenderit të Marrëveshjes bazë ku precizohet se në kontratat ndihmëse AK mund të përpilojnë specifikat me te avancuara dhe faktin që në FPO të publikuar nga AK janë vendosur

specifikat me të avancuara se ato të përcaktuar në marrëveshjen bazë, atëherë nuk mund të pretendohet se deklarata e specifikave teknike të dorëzuar me rastin e ofertimit për parakualifikim e përmbushë kërkesën e përcaktuar nga AK në FPO. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë OE që nuk plotëson specifikimet teknike minimale të paraqitura në ftesën për ofertim.

Rrethanat e çështjes

AK në Ftesën për Ofertim, të publikuar me datë 07.08.2023 tek Aneksi1-Specifikimet teknike të detyrueshme, për pozicionin 3- Brand Name All in One PC - Model IV, ndër të tjera ka kërkuar: Procesori: Intel Core i7 gjenerata e parafundit, (min 10-cores up to 5.0GHz) ose me i avancuar, Screen Resolution: FHD (1920x1080) IPS, Viewing Angle min .85° at te paktën djathtas/majtas/lart poshtë), borderless - multi touch (10 point), TouchScreen; Lexuesi optik: DVD RW (+/- RW) (nuk pranohen te jashtme) ; Grafika: Minimumi HDMI in, HDMI Out (2.1) ose porte te tjera me te mira (nuk pranohen combo portet).

OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 3, ka ofertuar me pajisjen HP EliteOne 840 23.8 inch G9 All-in-One, për çka ka dorëzuar edhe katalogun e pajisjes. Sipas informatave të prezantuara në katalog: Processors*: Intel Core i7-12700 with Intel® UHD Graphics (1.6 GHz E-core base frequency, 2.1 GHz P-core base frequency, up to 3.6 GHz E-core Max Turbo frequency, up to 4.8 GHz P-core Max Turbo frequency, up to 4.9 GHz with Intel Turbo Boost Technology, 25 MB L3 cache, 8 P-cores and 4 E-cores, 20 threads), supports Intel vPro Technology*;

Display: *60.5 cm (23.8") diagonal, FHD (1920 x 1080), IPS, anti-glare, Low Blue Light, 250 nits, 72% NTSC; 60.5 cm (23.8") diagonal, FHD (1920 x 1080), touch, IPS, anti-glare, Low*

Blue Light, 250 nits, 72% NTSC

Optical Storage: *HP 9.5 mm Slim DVD-Writer; HP 9.5 mm Slim DVD-ROM; HP 9.5 mm Slim Blu-ray writer*

Ports and Connectors: *HDMI-in 1.4; 1 dual-mode DisplayPort™ 1.4.*

Referuar vendimit të AK-së, datë 30.08.2023, rezulton, se AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e ankesës e OE ankues, me arsyetimin si vijon për këtë pikë: "[...] *1 .Sa i përket procesori qe ka ofruar grupi operatorëve ekonomike te shpërblyer me kontratë është procesor me shpejtësi 4.9 GHz qe dallimi vetme për 0.1 GHz dhe është i pranueshme pasi nuk ka kurrfarë ndryshimi ne aspekti teknik dhe ne aspektin e performances. Duke pasur parasysh stërzgjatjen e projektit nga muaji marse kur është bere kërkesa për inicim në mungesë te konkurrencës Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi Autoriteti kontraktues do te konsideroje një tender si te përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat c parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund te konsideroje një tender si te përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi te cilat mund te korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjale, ose (ii) përmban vetëm devijime te vogla qe nuk mund te shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera te parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit; me kusht qe, 9faredo devijimi i tille te kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe te merret parasysh gjate vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve. 2.Produkti i ofertuar nga OE "HP EliteOne 840 23.8 inch 09", përmban cilësitë e ekranit si ne vijime: •Touch: Ekran i ndjeshëm ndaj prekjes. Kjo është një përfitim për ata qe duan një përvojë interaktive mete drejtpërdrejtë me aplikacionet dhe softuerin.•!PS (In-Plane Switching): Teknologji e ekranit qe siguron pamje te qarta dhe ngjyra te qëndrueshme nga këndet e ndryshme te pamjes. •Anti-glare: Pennireson vizionin duke zvogëluar reflektimin e dritës qe vjen nga dritaret ose ndri9imi i ambientit. •Low Blue Light: Një karakteristike qe zvogëlon sasinë e dritës blu te dëmtueshme për sytë, veçanërisht gjate përdorimit te gjate. •250 nits, 72% NTSC: Nditesit*

e ndriqimit (nits) tregojnë ndriçiminin e ekranit. Për përvojë te mire vizuale, një ndriqim 250 nits është i mire. Spektri NTSC tregon për sasinë e ngjyrave qe mund te përshkruajë ekranin. 72% NTSC tregon një gamete gjere ngjyrash. Pra produkti i ofertuar nga grupi operatoreve ekonomike te shpërblyer me kontrate, përveç se i plotësojnë kërkesa ne disa raste dhe i tejkalon ato. 3.Produkti "HP EliteOne 840 23.8 inch 09", posedon HP 9.5 mm Slim DVD-Writer; HP 9.5 mm Slim DVD-ROM; HP 9.5 mm Slim Blu-ray writer ashtu siç është paraqit ne katalog, rrjedhimisht pretendimi se produkti i ofertuar nga grupi operatoreve ekonomike te shpërblyer me kontrate nuk përmbanë lexues optik nuk qëndron. 4.Produkti "HP EliteOne 840 23.8 inch G9", posedon portet si ne vijime: • 1 HDMI-in 1.4; • 1 dual-mode DisplayPort opcioni i fundit; •DisplayPort ka sistemi dual mode I cilin mundëson dhe te fute pamje ngjashme ne monitorë dhe te nxjerr pamje nga monitori veq kësaj ka dhe një port HDMI I cili vetëm nxjerr pamje. 5.HP EliteOne 840 23.8 inch G9" është një kompjuter desktop i klasës profesionale, i krijuar për tu përdorur nga bizneset, organizatat dhe përdoruesit e avancuar qe kane nevoje për performance të lartë dhe karakteristika të specializuara dhe klasat e larta. Garancioni i pajisjeve mund te konfirmohet ne çdo rast nga Autoriteti Kontraktues ne baze te numrit te produktit te pajisjeve. Deklarata e specifikave si kërkesë obligative ne kushtet e FPO-se, grupi operatoreve ekonomike te shpërblyer me kontrate është zotuar se do ti përmbushë te gjitha kërkesat e parapara ne Ftesën për Ofertim. Duke u bazuar ne ligjin për prokurim publike çdo kontratë i caktohet një menaxher i kontratës për kontroll dhe pranim te mallit dhe gjithashtu pranimi i mallit behet ne prezent te komisionit i cili caktohet për pranim te mallit ne baze te specifikave teknike qe janë kërkuar nga autoriteti kontraktues.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 2</u>

Në lidhje me pikat e pretendimit për mospërmbushje të specifikave teknike, Eksperti teknik sqaron si në vijim :

Lidhur me shpejtësinë e procesorit është evidente që dallon shpejtësia e procesorit të kërkuar me atë të produktit të ofertuar. Në vendimin e AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në lidhje me këtë pikë AK ka konstatuar se dallimi nuk ka kurrfarë ndryshimi ne aspekti teknik

dhe ne aspektin e performancës, ndërsa i është referuar Nenit 59, pikës (ii), ku thuhet se mund të pranohen vetëm devijime te vogla qe nuk mund te shkaktojnë ndryshime materiale me kusht qe devijimi te kuantifikohet, dhe te merret parasysh gjate vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve. Eksperti sqaron se devijimi i kuantifikuar ndërmjet shpejtësisë së kërkuar 5.0 GHz dhe asaj të produktit të ofertuar me 4.9 GHz, është 2 %, rrjedhimisht dallimi dhe ndikimi në performancë është minimal.

Ndërsa në lidhje me lexuesi optik: DVD RW, sipas broshurës së dorëzuar, qartësisht është paraqitur specifikimi HP 9.5 mm Slim DVD-Writer; HP 9.5 mm Slim DVD-ROM; HP 9.5 mm Slim Blu-ray writer, andaj nuk mund të pretendohet se nuk plotësohet ky specifikim teknik.

Më tej në lidhje ankimor për Grafikë përkatësisht porte, në dosjen e tenderit është kërkuar Minimumi HDMI in, HDMI Out (2.1) ose porte te tjera me te mira (nuk pranohen combo portet), ndërsa sipas broshurës së dorëzuar produkti i ofertuar ka portet: 1 HDMI-in 1.4; 1 dual-mode DisplayPort 1.4. Eksperti teknik sqaron se dy nga llojet më të zakonshme të konektorëve të monitorët modernë janë HDMI dhe DisplayPort të cilat përdoren për transmetimin e videos dhe audios në një ekran të kompaktibil. Megjithatë, varësisht nga standardi ka dallime në karakteristikat dhe kapacitetet. Një ndër dallimet është se tek displayPot 1.4 numri i ekraneve që mund të lidhen është deri në 4 përderisa tek HDMI 2.1 është vetëm një. Në anën tjetër tek HDMI 2.1 shpejtësia maksimale e transmetimit të të të dhënave është 48 Gbps, për dallim nga DisplayPort 1.4. që ka shpejtësi deri 32.4 Gbps. Si përfundim përparësia e njërit në raport me tjetrin port varet nga nevojat specifike. HDMI 2.1 ka përparësi për sa i përket shpejtësisë së transmetimit, mbështetjes me rezolucionin maksimal dhe veçorive të avancuara të audios, nga ana tjetër, mbështetja dhe prevalenca e DisplayPort 1.4 është për nevojat që kërkojnë konfigurime me shumë monitorë. Pra, në kontekst të kërkesës së AK-së, DisplayPort 1.4 mund të jetë port alternativ mirëpo nuk mund të cilësohet si port më i mirë në raport me HDMI 2.1.

Lidhur me pikën screen resolution, në dosjen e tenderit është kërkuar FHD (1920x1080) IPS Viewing Angle min .85° at te paktën djathtas/majtas/lart poshtë), borderless - multi touch (10

point), TouchScreen. Ndërsa sipas broshurës së dorëzuar produkti i ofertuar ka karakteristikat si vijon: FHD (1920 x 1080), touch, IPS, anti-glare, Low Blue Light, 250 nits, 72% NTSC. Pra është e qartë se produkti i ofertuar nuk është multitouch por vetëm touchscreen. Eksperti sqaron se të dy ekranet touch dhe multitouch lejojnë përdoruesit të ndërveprojnë me ekranin përmes prekjes, dallimi kryesor ndodhet në numrin e pikave të prekjes që mund të bëhen në të njëjtën kohë. Ekranët touch zakonisht mbështesin vetëm prekjen e një pike në një kohë, ndërsa ekranët multitouch mund të zbulojnë dhe të reagojnë në disa pika të prekjes në të njëjtën kohë, duke lejuar për ndërveprime më të avancuar dhe të shumanshëm. Numri "10 point" në "multi-touch (10 point)" tregon se ekranit i mundësohet të njohë deri në 10 pika të prekjes në të njëjtën kohë. Andaj, ekziston dallim në mes të ekranit të kërkuar dhe atij të ofertuar.

Në fund lidhur me pretendimin për ndërhyrje (manipulim) në broshurën e pajisjes HP EliteOne 840 23.8 inch G9 All-in-One, eksperti shqyrtues dhe teknik përmes emailit me datë 22.09.2023 kanë kërkuar konfirmim nga distributori i autorizuar (Pakom Company) i cili ka lëshuar autorizimin për OE Tech Vision si dhe përfaqësuesi i HP-së për regjionin e adriatikut, z.Drazen Marinovic. Me datë 25.09.2023 përfaqësuesi i HP-së z. Drazen Marinovic - Menaxher i shitjeve të përdoruesve fundorë, ka dërguar emailin me tekstin si vijon: "Broshura për HP EliteOne 840 G9 AiO PC është dokument publik dhe të gjithë mund ta marrin atë; https://h20195.www2.hp.com/v2/GetPDF.aspx/c08128755.pdf*.Nga pyetja juaj mund të supozoj se keni një shqetësim për garancinë e produktit të ofruar. Ju tërheq vëmendjen se garancia bazë për PC HP EliteOne 840 G9 AIO është 1 vit, por mund të rritet lehtësisht në 3 ose 4 ose 5 vjet garanci përmes HP care pack. HP nuk merr pjesë në vendimin e partnerit se çfarë garancie duhet të ofrojë dhe ky vendim është e drejtë autonome e partnerit HP.*

Në broshurën në linkun e dërguar vërehet qartë se garancia është një vjeçare, andaj edhe në ndërlidhje me pohimin e përfaqësuesit të HP-së se garancia bazë që prezantohet në broshurë nga prodhuesi është një vjeçare dhe se vazhdimi i viteve të garancisë mund të bëhet përmes HP Care Pack, eksperti shqyrtues dhe teknik vlerësojnë se nuk është përmbushur kërkesa për tre vite garancion nga prodhuesi sikurse është kërkuar në Aneksin1-Specifikimet teknike të

detyrueshme. Në lidhje me pjesën për pretendimin se është modifikuar nga OE, ekspertët i rekomandojnë panelit shqyrtues që të obligojë AK-në që të bëjë verifikime shtesë në lidhje me çështjen e ndërhyrjes në broshurë, dhe në rast të konstatimit se kemi të bëjmë me një dokument të falsifikuar, AK të kërkojë nga OSHP-së që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë OE nga pjesëmarrja në prokurim publik.

Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, në disa pika nuk plotësohen specifikimet minimale të kërkuara, rrjedhimisht pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit të anulohet dhe nëse AK me tutje ka interes të ritenderojë aktivitetin.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AXA SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica

Kreshnik Spahiu